



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 1764/1 Prishtinë 26.05. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Driton Salaj ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “Kontributi i muraturave në kapacitetet e strukturave duale prej beton armës” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Abstrakti

Për shkak të kërkesave të tregut për efikasitet dhe shpejtësi të ndërtimit, sot tek ne objektet ndërtohen në formë skeletore nga betoni i armuar, ku mbushjet me muraturë shërbejnë vetëm për ndarje të hapësirave dhe nuk parashihen të kenë efekte mbajtëse. Më së shumti ndërtohen objekte me sistem skeletor – elemente vertikale shtylla - pa mure dhe sistem dual i strukturës – elementet vertikale shtylla dhe mure sizmike. Në këto struktura mbushjet nga muratura zakonisht gjatë projektimit trajtohen si elemente jostrukturorë.

Me një logjikë të thjeshtë mund të kuptohet se këto mure ndarëse ekzistojnë dhe përveç që paraqiten si ngarkesë e përhershme e objekteve, ato kanë edhe efekt mbajtës duke ndihmuar strukturën në pranimin e ndikimeve nga jashtë. Pikërisht këtë efekt mbajtës të mbushjeve me muraturë në konstruksione duale nga betoni i armuar do të analizohet gjatë këtij punimi, duke u ndalur në analizën e pranimin të forcave të jashtme në përgjithësi dhe ndikimit sizmik në veçanti (ndikimi i muraturës në shtangësinë e sistemeve konstruktive).

Në tërmetin e fundit që ka ndodhur në zonën e Durrësit në vitin 2019, autori ka vërejtur se në shumë raste të objekteve të dështuara, struktura apo elementet strukturore i kanë rezistuar tërmetit duke mos u dëmtuar fare, mirëpo muraturat janë të dëmtuara në shkallë të madhe duke krijuar humbje të mëdha materiale ekonomike si dhe humbje të jetës së njerëzve. Kjo ndodh si pasojë e keq ekzekutimit të mureve ndarëse, lidhjeve jo të mira me elementet konstruktive, si dhe mosrespektimi i standardeve përkatëse në ndërtim.

Pikërisht për arsyet e lartpërmendura, në këtë punim analizohet edhe efekti i mënyrës së ndërtimit të muraturës, ndikimi i cilësisë së materialeve përkatëse si dhe mundësia e dhënies maksimale të rezistencës vetanake të muraturave pas ndërtimit të skeletit të objektit, duke dhënë vlerësime të bazuara në shembuj konkretë dhe në standarde të ndryshme të cilat i posedojmë në vendet tona.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është vlerësimi i sjelljes së strukturave me muraturë, gjegjësisht ndikimi i muraturave në sjelljen e strukturave ndaj ndikimeve të jashtme (ndikime pozitive dhe negative), bazuar në njohuritë aktuale shkencore të kësaj lëmie të përmbledhura në literatura, udhëzues, shembuj konkretë si dhe standarde përkatëse me parametrat e cilësive të materialeve të cilat përdoren në vendet tona.

Në fund të punimit jepen konkluzionet dhe propozimet për hulumtim të mëtejshëm.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.